



4909
DT 17.07.25

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 6811 Prot.

Elbasan më 07 . 07 . 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.56 datë 24.06.2025 “Për miratimin e listës shtesë të familjeve që plotësojnë kushtet për programin e subvencionimit të qirasë për vitin 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 698

Dt. 27.6.2025



VENDIM

Datë.26.06.2025

Nr. 4960 prot

Nr.56 dt.24.06.2025

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË FAMILJEVE QË PLOTESOJNË KUSHTET
PËR PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR VITIN 2025”**

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, VKM Nr.459, date 03.07.2019 “ Rregulla për administrimin e kërkesave të njësisve të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyren e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin “, V.K.B nr.97, datë 18.10.2024 “Mbi miratimin e sistemit të pikezimit për programet e strehimit”, Këshilli Bashkiak I mbledhur sot me date 24.06.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I :

- 1.Listën emërore shtesë të familjeve që do të përfitojnë subvecionim qiraje për vitin 2025. (Bashkangjitur tabela me listën emerore dhe shumat e subvencionimit).
- 2.Miratimin në parim të masës së subvencionit të qirasë me vlerë totale prej 84000 lekë për periudhën (Korrik-Dhjetor) viti 2025, për tu financuar në masën 100 % nga Bashkia Librazhd.
3. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit të Territorit dhe Pronës, dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55.pika 6 e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe pas shprehjes së ligjshmerisë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

RELACION

**“PËR MIRATIMIN E LISTËS SHITESË TË FAMILJEVE QË PLOTESOJNË
KUSHTET PER PROGRAMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR VITIN 2025”**

Në mbështetje të:

- Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2
- Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social” I ndryshuar, të neneve 3, 4, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji,
- VKM 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”,
- VKM 362, datë 29.05.2019 “për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gezojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”,
- VKM nr.459 datë 3.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësisë të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”,
- VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”,
- Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”,
- Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- VKB Nr.97 datë 18.10.2024 “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit

Referuar kërkesave të qytetarëve Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Territorit dhe Pronës mori në shqyrtim kërkesën e 2 aplikantëve.

Aplikanti Shahin Bitrosi i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për përfitimin e kompensimit të qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:
Burre dhe grua janë të moshuar rreth 74 vjeç. Prej kohësh jetonin në të njëjtën shtëpi me nusen e djalit të tyre, i cili ka ndërruar jetë para 8 vitesh. Pas një zënke në familje nusja i ka përzënë nga shtëpia. Aktualisht nuk kanë ku të banojnë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar qiranë e shtëpise.

Aplikanti Viturie Hoxha i përket kategorive që favorizohen nga ligji i strehimit për përfitimin e kompensimit të qirasë, pasi kjo familje aplikuese ka këto kushte:

Vituria 64 vjeç pensioniste, jeton vetëm pasi para 2 vitesh i ndërron jetë bashkëshorti.

Të ardhurat e saj janë të pa mjaftueshme për të paguar qiranë e shtëpise.

Për këto aplikantë kompesimi i bonusit të qirase do të financohet 100% nga bashkia.

Bashkia Librazhd ka parashikuar në buxhet totalin prej 3,000,000 lekë në dispozicion të familjeve që do të trajtohen nga programi i bonusit të qirase.

Buxheti i miratuar me VKB nr 108 datë 27/12/2024 .

Nr.	Emer/Atesi/Mbiemer	Perberje familjare	Kategoria (sipas pikes 45, e nenit 2, te ligjit 22/2018)	Aftesia perballuese sipas nenit 3 te ligjit	Qiraja e perballueshme	subvencioni ne muaj	subvencioni ne muaj qe mbulohet nga bashkia	Subvencioni per pjesen e mbetur te vitit qe mbulohet nga bashkia
1	Shahin Bitroshi	2	familje pa te ardhura, te moshuar	0%	0	7000	7000	42000
2	Viturie Hoxha	1	e moshuar, pa të ardhura	0%	0	7000	7000	42000

Propozojmë miratimin e listës nga Këshilli Bashkiak.

Konceptoi A.Teta
Pranoi A. Haskurti

